




2021-2030

PLANI STRATEGJIK

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË
KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE
SHOQËROR



Përmbajtja e lëndës

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK	2
1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit.....	2
1.2. Qëllimi Strategjisë.....	2
1.3. Lidhja me procesin e integritit në BE	2
2 Konteksti i Reformës dhe kuadri ligjor & institucional	2
2.1. Kuadri ligjor	2
2.2. Kuadri institucional	4
2.3. Dokumentë Strategjikë të Shëndetësisë	5
2.4. Arritjet dhe mësimet	5
3. Vizioni i Strategjisë & Qëllimet e Politikës	8
3.1. Vizioni	8
1.4. Arritja e Vizionit të Strategjisë për Zhvillim dhe Integrim	9
I. PLANI I MENAXHIMIT TË RISKUT	19
1. Skema e menaxhimit të riskut.....	19
2. Përgjegjësitë	21

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

1.1. Hyrje

Strategjia e Agjencise se Kujdesit Shendetesor dhe Shoqeror, 2021-2030, është një dokument i rëndësishëm që synon të përcaktojë dhe të arrijë objektivat e programit për mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullsisë shqiptare. Ky dokument u hartua në kuadrin për të përditësuar dhe përcaktuar për 10 vitet e ardhshme për sistemin shëndetësor, duke adresuar nevojat dhe kërkesat kryesore për shërbimet shëndetësore. Dokumenti mbështetet në punën e kryer deri me tani të sistemit shëndetësor.

Ky dokument përcakton objektivat kryesore për përmirësimin e shëndetit dhe kujdesit shëndetësor nepermjet sigurimit te cilesise për periudhën 2021-2030, megjithëse vizioni i paraqitur në këtë strategji do të jetë i përshtatshëm edhe për periudhën pas zbatimit zyrtar të kësaj strategjie.

Hartimi i Strategjisë te ASCKSHSH 2021-2030 u mbështet ne strategjine kombetare te hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Grupit të Punës, i cili u ngrit me Urdhrin Nr. 520 të datës 23.09.2020 nga Drejtori i Pergjithshem z.Denis Gjika.

1.2. Qëllimi Strategjisë

Qëllimi i strategjisë është vazhdimi i përpjekjeve për të përmirësuar shëndetin, mirëqenien e popullatës nepermjet sigurimit te cilesise për shëndet të mirë gjatë viteve 2021-2030.

Strategjia u hartua në konsultim të ngushtë me Strategjine kombetare te shendetesise me pjesëmarrjen e organizatave të pacientëve dhe përfaqësuesve të organizatave të tjera të shoqërisë civile që janë aktive në fushën e shëndetësisë, me ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë.

Strategjia e ASCKSHSH mbështetet në vizionin e shëndetit, misionin e tij, parimet e shëndetit dhe vlerat themelore të shëndetit.

1.3. Lidhja me procesin e integritimit në BE

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit midis Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë, (L107/166 Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, datë 28.4.2009)

Kapitulli 28 "Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndeti" i Planit Kombëtar të Acquis të BE-së për Integrimin Evropian 2019 - 2021.

2 Konteksti i Reformës dhe kuadri ligjor & institucional

2.1. Kuadri ligjor

- Ligji nr. 7643 datë 2.12.1992 "Për Inspektoriatin sanitar shtetëror" i ndryshuar.
- Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- Ligji nr. 8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese" i ndryshuar.
- Ligji nr. 8045, datë 7.12.1995 "Për ndërprerjen e shtatëzanisë" i ndryshuar.

- Ligji nr. 7975, datë 26.7.1995 "Për barnat narkotike dhe lendët psikotrope" i ndryshuar.
- Ligji nr. 8528, datë 23.9.1999 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gj" i ndryshuar.
- Ligji nr. 8615, datë 1.6.2000 "Për urdhrin e mjekëve ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- Ligji nr. 8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar.
- Ligji nr. 8876, datë 04.04.2002 "Për shëndetin riprodhues" të ndryshuar.
- Ligji nr. 9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- Ligji nr. 9150, datë 30.10.2003 "Për urdhrin e farmacistëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- Ligji nr. 9474, datë 9.2.2006 Për ratifikimin e konventës në kuadër të OBSH "Për kontrollin e duhanit".
- Ligji nr. 9579, datë 11.7.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Shqipërisë dhe shoqatës ndërkombëtare për zhvillim (IDA) për projektin "Modernizimi i sistemit shëndetësor".
- Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" i ndryshuar.
- Ligji nr. 9518, datë 18.4.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar" i ndryshuar.
- Ligji nr. 9493, datë 13.3.2006 "Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa S.P.A. për financimin e programit "Për pesë poliklinika në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë".
- Ligji nr. 9718, datë 19.4.2007 "Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.
- Ligji nr. 9739, datë 21.5.2007 "Për shërbimin e transfuzionit të gjakut ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- Ligji nr. 9928, datë 9.6.2008 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në RSH" i ndryshuar.
- Ligji nr. 9942, datë 26.6.2008 "Për parandalimin e crregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmeria e jodit në organizmin e njeriut" i ndryshuar.
- Ligji nr. 9952, datë 14.7.2008 "Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it" i ndryshuar.
- Ligji nr. 10138, datë 11.5.2009, "Për shëndetin publik" të ndryshuar.
- Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji nr. 10107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- Ligji nr. 10383 datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm e kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- Ligji nr. 10 469, datë 13.10.2011 Për mbrojtjen nga rrezatimet jo jonizuese" i ndryshuar.
- Ligji nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor" i ndryshuar.
- Ligji nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" i ndryshuar.
- Ligji nr. 138/2014 "Për Kujdesin Paliativ në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji nr. 89/2014 "Për Pajisjet Mjekësore" i ndryshuar.

- Ligji nr. 147/2014 "Për Shërbimin e Urgjencës Mjekësore".
- Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit".
- Ligji nr. 163/2014 "Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 127/2014 "Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e Infeksioneve dhe Sëmundjeve Infektive" i ndryshuar.
- Ligji nr. 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve".
- Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
- Ligji nr. 37/2017 "Kodi i drejtësisë penale për të mitur".
- Ligji nr. 17/ 2018 "Për statistikat zyrtare".
- Ligji nr. 23/2021 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë".
- VKM nr. 327, datë 28.5.2014 "Për përcaktimin e formatit dhe mënyrës së mbledhjes e të raportimit të të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, publik ose privat" të ndryshuar.
 - VKM nr. 788, datë 22.9.2015 "Për përcaktimin e kritereve, standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë" i ndryshuar.
 - VKM nr. 419, datë 04.07.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor".
 - VKM nr. 418 datë 4.07.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 788, Datë 22.09.2015, për përcaktimin e kritereve, standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë".
 - VKM nr. 418 datë 4.07.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 788, Datë 22.09.2015, për përcaktimin e kritereve, standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë".
 - VKM nr. 47, datë 30.01.2019 "Për miratimin e paketës së programit kombëtar të Depistimit të Kancerit të Qafës në RSH".
 - VKM nr. 380, datë 05.06.2019 "Për miratimin e dokumentit politik "Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019-2024 për zbatimin e tij".
 - VKM nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre".
 - VKM nr. 405 datë 20.5.2020 "Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri 2020-2025".
 - VKM nr. 182, datë 26.2.2020 "Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal" të ndryshuar.
 - VKM nr. 503, datë 24.6.2020 "Për mënyrën e administrimit të informacionit elektronik shëndetësor".
 - VKM nr. 175, datë 17.03.2021 "Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier, si projekt pilot".

2.2. Kuadri institucional

Sipas të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ministri që bashkërendon punën për çështjet e kujdesit shëndetësor dhe social është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pranë MSHMS, hartohen politikat dhe programet që kanë të bëjnë me çështjet e kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale në Republikën e Shqipërisë.

Institucionet e tjera të kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale në bashkëveprim ndërinstitucional në nivel qendror dhe vendor, bashkëpunojnë me ministrinë përkatëse që mbulon çështjet e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për të hartuar politika dhe shkëmbyer informacione adekuata në lidhje me zbatimin dhe garantimin e kujdesit shëndetësor për popullatën shqiptare.

2.3. Dokumentë Strategjikë të Shëndetësisë

- Strategjia e zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri 2020-2025
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017-2021
- Strategjia për parandalimin dhe zvogëlimin e dëmeve të lidhura me alkoolin (2017-2021)
- Strategjia kombëtare për një transfuzion gjaku të sigurtë
- Strategjia Kombëtare e Sigurimit të Kontraceptivëve
- Strategjia për parandalimin e HIV/AIDS
- Strategjia për shëndetin publik dhe promovimin shëndetësor
- Strategjia afatgjatë e zhvillimit të sistemit shëndetësor shqiptar
- Strategjia kombëtare për menaxhimin e sëmundjeve të lindura të gjakut
- Strategjia kombëtare për menaxhimin e sëmundjeve të lindura të gjakut
- Politikat dhe plani operacional për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit mendor në Shqipëri
- Plani i Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri 2013 – 2022
- Programi Kombëtar për Kontrollin e Kancerit
- Plani i Veprimit të Planifikimit Familjar
- Plani i Veprimit të Shëndetit Amtar
- Plani i Veprimit të Shëndetit Femijëve dhe Adoleshentëve
- Plani i Veprimit Infeksione Seksualisht të Transmetueshme dhe HIV/AIDS
- Plani i Veprimit të Kancereve të Traktit Riprodhues
- Plani i Veprimit mbi Gjininë dhe Dhunen
- Plani i Veprimit për Infertilitetin
- Plani i Veprimit për sigurinë e kontraceptivëve 2017 – 2021
- Plani i Veprimit për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri 2020-2025

2.4. Arritjet dhe mësimet

Shqipëria është një vend që ka bërë zhvillime të jashtëzakonshme gjatë dy dekadave të fundit. Gjatë periudhës 2016-2020, një sërë ndryshimesh të akteve ligjore dhe rregullative si dhe projektvendime të reja, janë miratuar nga Parlamenti Shqiptar në fushën e shëndetësisë. Miratimi i tyre ka ardhur si përgjigje ndaj nevojave në sektorin e shëndetësisë. Këto janë të shprehura në dokumente të ndryshme strategjike dhe janë hartuar dhe sirrjedhojë e ndryshimeve dhe zhvillimeve të reja në Shqipëri në kuadrin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë (SKSH) 2016-2020 luajti një rol të rëndësishëm në përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e shëndetësisë, si rezultat i vendosjes së shumë objektivave specifike që synuan përmirësimin e shëndetit të popullatës shqiptare nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, duke përfshirë edhe ato ligjorë.

Zhvillimet më të fundit në këtë fushë

Disa nga fushat me ndryshimet kryesore legjislative në vitet e fundit janë si më poshtë vijon:

- Organizimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor në Shqipëri, përfshirë hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor në lidhje me pajisjet mjekësore
- Ushqimi dhe ushqyerja e shëndetshme e popullsisë shqiptare
- Ndryshimet në Ligjin e Duhanit për popullsinë shqiptare
- Ndryshimet në Ligjin për jodizimin e kripës për parandalimin e çrregullimeve të tiroides
- Ndryshimet në Kodin Penal për rregullimin më të mirë të mbrojtjes së Punonjësve të Kujdesit Shëndetësor gjatë punës së tyre.
- Parandalimi i sjelljeve të rrezikshme që lidhen me:
 - Përdorimin e alkoolit dhe pijeve energjike nga fëmijët
 - Parandalimi i dhunës në familje
 - Parandalimi i dhunës ndaj fëmijëve
- Përmirësimi i funksioneve dhe strukturave të inspektimit sanitar në nivel kombëtar
- Moszbatimi i masave nga autoritetet shtetërore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose gjatë gjendjes së epidemisë
- Përmirësimi i standardeve etike dhe profesionale në ushtrimin e profesionit të psikologut.

Vitet e fundit, si pjesë e transformimit të sistemit shëndetësor, janë konceptuar dhe ndërmarrë reforma madhore në lidhje me riorganizimin dhe rikonceptimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Këto reforma strukturore në sistemin shëndetësor kanë përfshirë krijimin dhe bashkimin e institucioneve shëndetësore në nivel vendor dhe lokal si dhe krijimin e institucioneve të reja në nivel kombëtar.

Kjo reformë institucionale ka çuar në krijimin e institucioneve të reja, siç ishte krijimi i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, i përbërë nga katër (4) Drejtori Rajonale (Tiranë, Shkodër, Elbasan, Vlorë) të cilat kanë ndërmarrë një sërë funksionesh menaxheriale që lidhen me planifikimin, menaxhimin dhe administrimin e ofrimit të kujdesit shëndetësor në nivelin parësor dhe dytësor.

Kujdesi shëndetësor në Shqipëri tashmë ka hyrë në një rrugë pa kthim, rruga drejt transformimit dhe modernizimit të tij.

Disa nga objektivat e përcaktuara në programet e qeverisë shqiptare janë arritur gjatë këtyre tetë (8) viteve të fundit nëpërmjet (i) rritjes së financimit publik për shëndetësinë; (ii) përmirësimit të kujdesit parësor; (iii) hartimit dhe zbatimit të programeve të parandalimit të sëmundjeve; (iv) zgjerimit të aksesit në trajtimin mjekësor; (v) përmirësimit të infrastrukturës së qendrave shëndetësore dhe spitalore dhe (vi) zgjerimit të nevojave të komunitetit për kujdes shëndetësor, duke ofruar më shumë shërbime pranë vendbanimit, për qytetarët shqiptarë.

Të gjitha këto zhvillime janë shoqëruar me një reformë më të gjerë territoriale kombëtare, nëpërmjet integritetit të komunave të vogla në komuna më të mëdha dhe me zbatimin e një procesi të decentralizimit, që synon në sigurimin e llogaridhënies në nivelin e qeverisjes vendore.

Përsa i përket shpenzimeve të përgjithshme të sistemit shëndetësor, Qeveria vendosi të zhvendosë fokusin e përgjithshëm të sistemit shëndetësor nga sëmundja në shëndet dhe nga shpenzimet në investime. Ky është një ndryshim i rëndësishëm në mënyrën e konceptimit të sistemit shëndetësor dhe tashmë ka rezultuar në fillimin e disa zhvillimeve kryesore.

Si shembull, gjatë periudhës nga viti 2013 deri në vitin 2020 buxheti për shëndetësinë u rrit 55.4% duke arritur vlerën e 55 322 miliardë lekë në vitin 2020. Buxheti i dhënë për sektorin e shëndetësisë konsistoi në 9.4% të shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë dhe rreth 3.4% të PBB -së në vitin 2020.

Në 8 vitet e fundit janë kryer investime në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor duke filluar nga parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi për përmirësimin e aksesit në kujdesin shëndetësor në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor si ai parësor, dytësor dhe terciar.

Si pjesë e rritjes së këtyre investimeve, u lançua Programi Kombëtar për Rinovimin e 300 qendrave shëndetësore. Ky program, shërbeu për të rinovuar dhe përmirësuar 186 qendra shëndetësore dhe ambulanca gjatë viteve buxhetore 2018-2019 dhe 111 qendra shëndetësore parësore dhe ambulanca në vitin 2020.

Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka ndërmarrë gjatë viteve të fundit masa për të siguruar që shpërndarja e shpenzimeve të kujdesit shëndetësor të jetë më efikas dhe e qëndrueshme duke zhvendosur më shumë burime drejt kujdesit parësor, pra parandalimit të sëmundjeve, me qëllim për të zvogëluar barrierat financiare për përdorimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor p.sh., në programet e kontrollit shëndetësor (check-up) për popullatën e grupmoshës 35-70 vjeç. Gjithashtu, vlen të përmendet se OBSH-ja i ka bërë thirrje të gjitha vendeve që të investojnë nëpërmjet programeve të financimit 1% shtesë të PBB-së në KSHP, kjo theksohet në raportin e botuar¹.

Programi Kombëtar i aplikuar nga viti 2015, mbi Kontrollin Shëndetësor Bazë për qytetarët e moshës 35-70 vjeç është një nga investimet më të mëdha në këtë drejtim dhe ka kontribuar në rritjen e përdorimit të shërbimeve, veçanërisht në zonat dhe popullsitë që kanë pasur më pak akses në shërbime të kujdesit parësor, më parë. Vlen të theksohet se vetëm në vitin 2020 janë mbi 6 milion qytetarë në të gjithë vendin që kanë marrë kujdes shëndetësor parësor, sipas të gjitha standardeve bashkëkohore. Shifër kjo që ka ardhur duke u rritur nga viti në vit.

Si pjesë e rritjes së investimeve në shëndetësi, pagat e mjekëve dhe infermierëve u rritën me 40% në vitin 2021 bazuar në Vendimin e Qeverisë² me qëllim ruajtjen e burimeve njerëzore, profesionistëve shëndetësorë në vend por dhe rritjen e kënaqësisë së tyre për të punuar në sektorin shëndetësor publik. Paga mesatare bruto për mjekët u rrit me 22 800 lekë duke arritur në nivelin 110 553 lekë në vitin 2021. Për infermierët, rritja e pagës mesatare bruto u planifikua me 14 810 lekë duke arritur në nivelin e 65 700 lekë në vitin 2021.

Cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve është një komponent tjetër thelbësor i mbulimit të kujdesit shëndetësor universal i cili vitet e fundit ka përfshirë nisma dhe reforma të reja gjithëpërfshirëse, të cilat kanë filluar vitet e fundit, sikundër janë:

- Fillimi i procesit për përshtatjen e standardeve të cilësisë dhe protokolleve bazë mjekësore në të gjitha qendrat e kujdesit shëndetësor parësor;
- Investimi, përmirësimi dhe rindërtimi infrastrukturës, veçanërisht në kujdesin parësor shëndetësor;
- Krijimi i një sistemi të dixhitalizuar kombëtar përpara i përket sistemit të referimit, të planifikimit, të rekomandimit, të përshkrimit të recetës elektronike, të nënshkrimit elektronik, dhe të konsultës/vizitës elektronike;
- Forcimi i kapaciteteve rajonale diagnostikuese dhe depistuese nëpërmjet programeve të dedikuara sikundër janë futja e njësisive të lëvizshme të mamografisë për depistimin e kancerit të gjirit në qendrat rajonale dhe zonat më të thella të vendit, duke rezultuar në një rritje të konsiderueshme të shërbimeve diagnostikuese.
- Programi i Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës, i cili filloi në vitin 2019 dhe vazhdon pavarësisht ndikimit të COVID-19.
- Programi Kombëtar për Depistimin e Kancerit të Gjirit, i cili filloi në vitin 2018.
- Vaksina kundër Rotavirusit, që u përfshi në Kalendarin e Vaksinimit, duke e çuar numrin e vaksinave falas për fëmijët 0-18 vjeç në një total prej 12 vaksinash.

Ndër nisimat e reja të përmendura më lart, depistimi i kancerit të qafës së mitrës ofron një paketë kujdesi shëndetësor falas për gratë e grupmoshës 40-49 vjeç duke filluar nga testimi e vazhduar më pas me trajtimin e tyre. Programi ofrohet nga 413 qendra shëndetësore të kujdesit parësor në Shqipëri dhe deri më sot rezultatet tregojnë se janë mbi 17 000 gra të cilat i janë nënshtruar ekzaminimit që nga fillimi i programit. Në përgjithësi, rreth 5% e tyre rezultuan pozitive për HPV dhe ndiqen nga specialistë të kujdesit shëndetësor.

¹ OBSH, Shpenzimet për shëndetin në Evropë: Hyrja në një epokë të re (2021)

² Ligji nr. 137/2020 "Buxheti i vitit 2021"

Nga lançimi i depistimit të kancerit të gjirit përfituan mbi 74 mijë të grupmoshës 50-65 vjeç, të cilat iunështruan teste falas të mamografisë që nga fillimi në vitin 2020 (33.6% në 2 mamografi të lëvizshme dhe 66.4% në mamografi stacionare pranë spitaleve).

Me përfshirjen e vaksinimit për rotavirusin, numri i përgjithshëm i vaksinimeve falas në Programin Kombëtar të Vaksinimit dhe Imunizimit për Fëmijët 0-18 vjeç u rrit në 12, dhe 240 000 fëmijë u vaksinuan që nga përfshirja e vaksinës së re në program.

Masat e marra për të plotësuar nevojat në rritje për shërbime të specializuara shëndetësore:

- Përshtatja e standardeve të cilësisë dhe protokolleve bazë në të gjitha spitalet rajonale të vendit.
- Stimuj për përmirësimin e shpërndarjes së mjekëve specialistë në të gjithë territorin e vendit.
- Intensifikimi i programeve të specializimit për brezat e rinj të mjekëve, në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë.
- Përmirësimi i teknologjisë; trefishimi i gamës së testeve laboratorike që ofrohen falas në spitale dhe më shumë shërbime mjekësore emergjence, duke përfshirë 35 ambulanca të reja.
- Krijimi i qendrave të reja urgjente hemodinamike kardiake në spitale rajonale
- Sigurimi i një pakete regjimentesh për trajtimin efikas të kancerit të gjirit dhe kancereve të tjera merëndësi për shëndetin publik.
- Ndryshimet ligjore për të integruar më mirë ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor privat mesistemin më të gjerë të ofrimit të shërbimeve.

Efektet e reformave shëndetësore të ndërmarra vitet e fundit dhe rritja e mbulimit universal të popullatës shqiptare nëpërmjet programeve dhe politikave të reja shëndetësore, në shërbime, financime, ka bërë që kjo të jetë e dukshme dhe e prekshme në rezultatet dhe treguesit shëndetësorë. Kështu, treguesi dhe tendenca e vdekshmërisë së standardizuar sipas moshës (një tregues i vdekshmërisë që shmang efektin e plakjes së popullsisë) për disa grupe të rëndësishme sëmundjesh, ka filluar të ulet në Shqipëri.

3. Vizioni i Strategjisë & Qëllimet e Politikës

3.1. Vizioni

Vizioni i strategjisë: I përgjigjemi së tashmes dhe së nesërme me në qendër qytetarin.

Misioni i strategjisë: Mbrojtja, përmirësimi dhe promovimi i shëndetit. Rritja e mirëqënies dhe produktivitetit të të gjithë qytetarëve në Shqipëri. Garantimi i ofrimit të kujdesit shëndetësor cilësor në kohë dhe të përballueshëm për popullatën shqiptare. Sigurimi i progresit të qëndrueshëm në shëndetin publik dhe kujdesin shëndetësor.

Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit shëndetësor për emergjencat dhe shfrytëzimi i inovacioneve dhe integritetit të kujdesit për fuqizimin e sistemit shëndetësor.

Parimet e përgjithshme që udhëheqin strategjinë:

- Mosdiskriminimi
- Interesi më i mirë i pacientëve
- Për shëndetin, për mirëqenien fizike, mendore dhe sociale (përkufizim i OBSH-së)
- Gjithëpërfshirja
- Pjesëmarrja

Vlerat: Universaliteti, qëndrueshmëria, cilësia, qendërimi i individit, përqëndrimi ndaj shëndetit si një e mirë njerëzore dhe publike, inovacioni, integriteti, efikasiteti dhe efektiviteti i sistemit, transparenca, llogaridhënia, dinjiteti, barazia gjinore dhe përfshirja.

Pikat fillestare të strategjisë:

- Sigurimi i vazhdimësisë së punës së kryer në kuadër të Strategjisë Kombëtare Shëndetësore të mëparshme (2016-2020);
- Adresimi i mangësive aktuale dhe sfidat e ardhshme që paraqiten për sistemin shëndetësor;
- Pasqyrimi i perspektivave novatore dhe zhvillimi i vazhdueshëm i sistemit shëndetësor duke marrë parasysh gjithashtu angazhimet ndërkombëtare si: Rregulloret Ndërkombëtare të Shëndetit dhe marrëveshjet e lidhura për shëndetin në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit midis Komisionit Evropian dhe Shqipërisë;
- Mundësimi i koordinimit të përpjekjeve midis ministrive dhe sektorëve të ndryshëm; dhe udhëzimi i kuadrit rregulator kombëtar drejt një axhende të harmonizuar dhe efikase për shëndetin.

Premisat kryesore të strategjisë:

- Të gjitha veprimet e planifikimit duhet të bazohen në evidenca, të koordinohen dhe të monitorohen dhe vlerësohen në mënyrë efikase për të siguruar rezultate më të mira shëndetësore për njerëzit në përgjithësi, në mënyrë të drejtë;
- Të gjitha shërbimet shëndetësore duhet të jenë të një cilësie të mirë, duke ndjekur parimet e përqendrimit tek pacienti, barazisë dhe standardeve të larta, dhe duke u përkushtuar ndaj një qasjeje që bazohet në të drejtat e njeriut;
- Burimet duhet të shpërndahen dhe menaxhohen në mënyrë efikase.

1.4. Arritja e Vizionit të Strategjisë për Zhvillim dhe Integrim

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror ka për mision të saj **sigurimin e cilësisë së produkteve /përfitimeve të kujdesit shëndetësor me të gjitha elementet e tij nga të gjithë ofruesit (publike ose privatë), me qëllim garantimin e kujdesit shëndetësor, shoqëror e cilesor dhe të bazuar në standarte , nëpërmjet edukimit, certifikimit dhe kontrollit të sigurisë së shërbimeve për strukturat dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe shoqëror.**

Misioni i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror është pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI), e cila përcakton synimet dhe strategjitë afatmesme dhe afatgjata të qeverisë për të gjithë sektorët bazuar në një vizion kombëtar, e miratuar më datë 11 maj 2016 me VKM Nr.348, është një përmbledhje e të gjitha strategjive dhe politikave qeveritare, duke përfshirë strategjitë ndër-sektoriale dhe politikat rajonale.

Në këtë mënyrë, Strategjia e AsckSHSH si pjesë integrale e strategjisë kombëtare të Shëndetësisë kontribuon fuqishëm nëpërmjet objektivit

“Një sistem më i fortë, më cilësor dhe më i aksesueshëm për kujdesin shëndetësor dhe shoqëror”

e cila si më poshtë vijon:

- Të ofrojë asistencë të vazhdueshme për profesionistët e shëndetësisë në lidhje me hapat dhe procedurat që duhen ndjekur për përmbushjen e kërkesave të ricertifikimit .

- Të përpunojë dhe analizojë të dhënat nga Regjistri Kombëtar i certifikimit si dhe të hartojë raporte për institucionet e interesuara.
- Të kryejë në kohë hedhjen e të dhënave të paraqitura nga kërkesat e individëve ose/dhe subjekteve privatë apo publikë për regjistrimin e të gjithë profesionistëve të shëndetësisë që bëjnë pjesë në programin e certifikimit.
- Të kryejë regjistrimin e krediteve nga aktivitetet e paraakredituara nga QKEVsi dhe të akredituara nga institucione jashtë vëndit
- Të kryejë vlerësimin dhe regjistrimin e krediteve të aktiviteteve individuale dhe të vetraportuara.
- Të komunikojë me profesionistët duke iu ofruar atyre asistencë të vazhdueshme në lidhje me kriteret dhe detyrimet e programit të certifikimit.
- Në bashkëpunim me specialistët e sektorëve të tjerë krijon tabelat statistikore të të dhënave të Regjistrit Kombëtar të certifikimit.
- Të gjenerojë nga D-base raporte me informacione të ndryshme për profesionistët e regjistrit të certifikimit, në lidhje me kreditet e marra në vite sipas kohës së regjistrimit, specialitetit dhe institucionit ku ushtron profesionin.
- Të arshivojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton regjistrimin e profesionistëve të shëndetësisë në regjistrin kombëtar të riçertifikimit dhe kreditet e përfituara nga pjesëmarrja në aktivitetet e edukimit në vazhdim.
- Vlerësimi në kohë dhe me cilësi i aplikimeve për akreditim të aktiviteteve të edukimit në vazhdim
- Përshtatje e dokumentit rregullator të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim sipas ndryshimeve të fundit të vkm 788
- Përditësim i kriterëve të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim sipas ndryshimeve të fundit të vkm 788
- Përditësim i Standardeve të Edukimit në Vazhdim (nentor 2009)
- Përditësim i udhëzuesit për procedurat dhe kriteret e akreditimit të AEV për profesionistët e shëndetësisë (mars 2016)
- Përditësim i udhëzuesit për vlerësimin e brëndshëm të AEV për profesionistët e shëndetësisë (mars 2016)
- Rritje e numrit të aplikimeve për akreditim të AEV
- Rritje e numrit të aplikimeve për akreditim të ofruesve të edukimit në vazhdim
- Pranimi I kërkesave për përsëritje aktiviteti përmes portalit e-albania
- Shtim në e-albania të shërbimit “ Aplikim për akreditim të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e kujdesit shoqëror”

- Miratimi I listes se eksperteve per vleresimin e AEV shoqeror
- Gjetja dhe vendosja e lidhjeve te qendrueshme me aktoret relevant ne Stafin menaxhes te QSUT/ MSHMS/Operator per te mbeshtetur procesin e bashkepunimit me stakholder-sat e siperpermendur.
- Gjetja e mundesive per mbeshtetje financiare ne bashkepunim me shoqatat e profesionisteve per procesin e ketij hartimi/perditesimi.
- Afrimi I disa shoqatave profesionistesh ne mbeshtetje financiare te procesit te siperpermendur.
- Sfidat qe lidhen me problematika te logjistikes dhe vendosjes se nje rrjeti funksional komunikimi me anetaret e grupeve te punes gjate testimit te kesaj praktike pune.
- Mundesimi I I nje ambjenti per takimet e grupeve te punes per hartimin e UPK PPK
- Hartimi I nje udhezuesi per praktiken e monitorimit te zbatimit te protokolleve te hartuara.
- Kerkimi dhe seleksionimi I praktikave me te mira te huaja qe jane njekohesisht dhe te pershtatsheme me sistemin tone shendetesor, ne hartimin e ketij udhezuesi.
- Hartimi I nje pyetesori per ndihmuar ne procesin e rishikimit, nga stafet zbatuese, te vlefshmerise se protokolleve te hartuar.
- Hartimi I nje pyetesori rishikimi, qe te permbaje experiencen me te mire qe egziston ne vend, por dhe ne vende te tjera, lidhur me kete process
